

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE TETOR-DHJETOR 2024

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	29.09.2024	Dërgohen bashkëlidhur dokumentacioni plotësues për procedurën e legalizimit	01.10.2024	Në vijm të kërkesës tuaj date 29.10.2024 të ardhur me e-mail ne te cilen paraqisni dokumentacion bashkelidhur per vijimin e procedures se legalizimit me vetdeklarim nr. 1484 në dt. 15.07.2023 për objektin informal të ndodhur në lagjen “Kala”, Elbasan , ju sqarojmë si më poshtë: Në mënyrë që kërkesa juaj të merret në shqyrtim, bazuar në VKM Nr. 1040/2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndertimet pa leje”, referuar Kreut IV, pika 28, citohet se: Pika 28. “Për zbatimin e dispozitave të këtij vendimi, që kërkojnë shprehjen e autoriteteve të trashëgimisë kulturore, drejtoria vendore e ASHK-së vendos në dispozicion të këtyre autoriteteve dokumentacionin e praktikës së legalizimit: genplan, planimetritë si dhe dokumentacionin që duhet të sigurohet nga vetë poseduesi i ndërtimit kur ai është i nevojshëm, sipas rastit: fotografi të ndërtimit, prerje teknike të objektit për legalizim, fasadat teknike dhe relacionin Teknik”. Të gjitha këto materiale dorëzohen pranë sekretarisë teknike të KKTKM-së me CD, shoqëruar me prezantim në format Poëerpoint. Per sa me siper, duhet që drejtoria vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përmes një shkrese zyrtare, të vendosi në dispozicion të autoritetit të trashëgimisë kulturore dokumentacionin e praktikës së legalizimit.	E plotë	Jo
2	01.10.2024	Informacion mbi materialet arkivore fotografike qe disponon arkivi IGTK per pasurine kulturore "Kalaja e Shkodres", te viteve '70-90'-te shek XX-te si dhe te objekteve historike brenda saj.		Në vijim te te kodeve te fotove te perzgjedhuara nga ana juaj, referuar kartelave te derguara, per objektin pasuri kulturore "Kalaja e Shkodres", mbështetur në Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, neni 61 “Dokumentet që administrohen në institucionet arkivore shtetërore, jepen për shfrytëzim pasi kanë kaluar 25 vjet nga data e krijimit”	E plotë	Jo

				dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur kopje elektronike të disa prej fotove (negativ) te skanuar, për të cilat është përcaktuar viti dhe autori i fotos. Gjithashtu, mbështetur në Ligjin nr 35/ 2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, duke qënë se krijimet fotografike janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit, lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumentacioni arkivor. https://ëëë.transferxl.com/it/download/08zv1QKFMbSd1g		
2	01.10.2024	Sqarim mbi vendimin nr. 206, date 19.04.2023 të KKTKM-së.	02.10.2024	Ne pergjigje te emailit tuaj, pas shqyrtimit te rastit, si dhe pas verifikimit te dokumentacionit te aplikuar ne sistemin e-albania me nr. AN..... dhe aplikues z/znj.....rezulton se: Emertimi i projektit, njesia strukture, planvendosja, si dhe pronaret e truallit, jane te njejte me objektin e kerkeses me nr. Regjistri/protokolli K-3123 dt.22.07.2024, se ciles IKTK i ka kthyer pergjigje me shkresen nr.Prot., 1220/1 date 26.07.2024, por ndryshimi qendron vetem te emertimi i zhvilluesit, per te cilen IKTK nuk eshte bere me dije ne momentin e ndryshimit dhe aplikimit per vijimin e procedures ne bashki. Per sa me siper, dhe ndodhur ne kushtet kur KKTKM ka miratuar nje raport vezhgimi per kete zone (me Vendim nr. 206 date 19.04.2023), nuk eshte e nevojshme te aplikohet serish prane Sekretarise Teknike te KKTKM, ne IKTK me raport vezhgimi per vednimarrje prane KKTKM-se.	E plotë	Jo
3	03.10.2024	Kërkohet informacion i detajuar nga banorët e fshatit Vodice, Rrethi Kolonje, Erseke, ne lidhje me: - Nëse objekti Kisha e Shën Marise ne fshatin Vodice është pasuri kulturore monument kulture i shpallur;	07.10.2024	Në vijim të e-mailit të dërguar nga ana juaj në lidhje me kërkesën e banorëve të fshatit, Vodicë, Bashkia Kolonjë, për kishën e Shën Marisë në këtë fshat, Ju bëjmë me dije se: Nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Korçë është kryer verifikimi i listës me të gjitha monumentet e kulturës që ka në përgjegjësi administrimi institucioni, ku u	E plotë	Jo

		- Ne rast se nuk është pasuri kulturore e shpallur, informacion nëse ka patur kërkesa për verifikim të interesit kulturor.		konstatua se objekti “Kisha e Shën Mërisë” në fshatin Vodicë, Kolonjë: - nuk rezulton të jetë pjesë e Listës së Monumenteve të Qarkut Korçë, pra nuk është në përgjegjësi administrimi nga DRTK Korçë. - nga verifikimi manual pranë protokollit gjithashtu nuk është konstatuar të ketë pasur ndonjë shkresë/kërkesë për verifikim të interesit kulturor.		
4	07.10.2024	“Kërkesë për leje për ndërhyrje në objektin Monument Kulture i kategorisë së I-rë “Porta e banesës Çano”	25.10.2024	Në vijim të kërkesës tuaj, datë 08.10.2024, ardhur nëpërmjet postës elektronike të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, me objekt: “Kërkesë për leje për ndërhyrje në objektin Monument Kulture i kategorisë së I-rë “Porta e banesës Çano” Ju bëjmë me dije se, “Porta e banesës Çano” është shpallur Monument Kulture i Kategorisë së I-rë nga Ministria e Kulturës me Urdhër Nr. 390, datë 26.10.2005. Në kuptim të Ligjin Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", “Monument Kulture i kategorisë I-rë” është ndërtimi me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore, i cili ruhet në tërësinë e përbërësve të tij arkitektonikë dhe teknikë. Kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme e të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike e funksionale e këtyre monumenteve nuk mund të ndryshohen. Neni 77, Pika 2 ç) i po të njëjtit Ligj përcakton se: Kryhen vetëm me leje të Keshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM): gërmimi, restaurimi, përdorimi dhe çdo veprim tjetër në pasuritë kulturore, si dhe çdo ndërhyrje në truallin e vënë në mbrojtje rreth tyre. Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në monumente të veçanta hartohen nga institucione shtetërore të specializuara ose nga subjekte të licencuara për këtë qëllim. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) e më pas vijojnë procedurën përkatëse, sipas ligjit për planifikimin e territorit. Zbatimi i punimeve të restaurimit kryhet nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, ose subjekte të licencuara për këtë kategori ndërtimesh.	E plotë	Jo

				Për sa më sipër, ju mund ti drejtoheni institucioneve shtetërore të specializuara apo subjekteve private të liçencuara në fushën e projektimit me liçencën përkatëse në restaurim, në mënyrë që të hartojnë dhe aplikojnë projektin e mirëmbajtjes apo restaurimit në sportelin unik të KKTKM-së, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Aplikimi për "Leje për ndërhyrje në Pasuri Kulturore Materiale" kryhet nëpërmjet portalit E-Albania, duke përdorur shërbimin "Leje për ndërhyrje në pasuri Kulturore Materiale". Subjekti aplikues mund të aksesojë këtë shërbim në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/ealbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13702 për vijimin e procedurës së shqyrtimit deri në vendimmarrjen e KKTKM-së.		
--	--	--	--	---	--	--

5	11.10.2024	Kërkesë për Informacion për disa vendime të marra ndër vite për rekomandimet e restaurimeve të disa monumenteve të kulturës, të ndodhura në zonat ku janë ndërtuar disa HEC-e në vend.	28.10.2024	Ne vijim te emalit tuaj, duke ju kerkuar ndjese per vonesen per shkak te ngarkeses se institucionit, Lutemi te merret ne konsiderate pergjigjia e meposhteme, bazuar ne kerkesen tuaj, si vijon: 1. Në lidhje me Vendimi Nr. 1, Datë 01.02.217 “Për ndërtimin e hidrocentralit “HEC ZALL TORRE”, në rrjedhën e përroit të Radicës, në ish komunën Stravaj. - Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e “Ura e Golikut”, sipas projektit preventiv që do të miratohet IMK. Konstatohet se shoqëria nuk ka kontribuar pasi ndërtimi i Hecit nuk ka filluar akoma, dhe ka projekt të miratuar për monumentin me Vendimin Nr. 433 datë 13/11/2018 nga KKR. 2. Në lidhje me Vendimi Nr 11, Datë 10.01.2018 Miratimi i projektit ‘Ndërtimi i HEC SLABINJA 2 C’ deri në veprën e marrjes së “HEC Slabinjë 2D zona e Mokrës” në pellgun e lumit Shkumbin Pogradec, me subjekt aplikues “HIDROPOËER-ELEKTIK” sh.p- Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture “Ura e Golikut”. Shoqëria ka kontribuar duke kryer ndërhyrjet në “Urën e Golikut” duke financuar fazën e parë të projektit total në blerjen e materialeve dhe kryerjen e punimeve sipas preventivit dhe projektit të miratuar me Vendimin Nr. 433 datë 13/11/2018 nga KKR. Për vendimet e marra në lidhje me territorin e administruar nga sektori i Elbasanit në lidhje me vendimet e poshtëshënuara, jemi bërë me dije se nuk ka njoftim për fillim punimesh nga ana e subjekteve. 3. Vendimi Nr 120, Datë 21.03.2018 Miratimi i projektit “Ndërtimi i burimit rigjeneruar të energjisë Hidrocentrali Shumbin, fshat Prevallë, bashkia Librazhd, Qarku Elbasan. -	E Plotë	Jo
---	------------	--	------------	---	---------	----

			Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture “Ura e Kamarës”, Mirakë, Librazhd, Elbasan. Ka projekt të miratuar KKTKM me vendimin nr. 269 datë 31.05.2018. Punimet e HEC-it kanë përfunduar në vitin 2020, por punimet për Urën e Kamares nuk kanë filluar ende. 4. Vendimi Nr. 174, Datë 18.04.2018, Miratimi i projektit “Ndërtimi i HEC “Miraka” në basenin e ujëmbledhës të lumit Shkumbin, në përroin e lugjeve dhe degët e saj, Bashkia Librazhd- Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture “Ura e Kamarës”, “Ura e Kecit”. Projekti i Urës së Keçit nuk është realizuar ende. Objekti është rrënojë ka vetëm disa gjurmët tij. Projekti i Urës së Kamares është hartuar nga IKTK dhe është miratuar nga KKTKM me vendimin nr. 269 datë 31.05.2018. Punimet e HEC kanë filluar dhe janë në proces. Punimet për monumentin ende nuk kanë filluar. 5. Vendimi Nr. 287, Datë 11.06.2018 Miratimi i projektit “Ndërtimi i Hec Kelis, lumi Shmil, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan. -Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture “Ura mbi përroin e Labinotit në fshatin Labinot-Mal, Qarku Elbasan. Punimet për restaurimin e monumentit ende nuk kanë filluar, por subjekti është treguar i gatshëm të kontribuar që për të dhe është në pritje të miratimit të projektit. Punimet e HEC-it kanë përfunduar në vitin 2021. Projekti është hartuar nga DRTK Korçë- Sektori Elbasan dhe është në proces miratimi. 6. Vendimi Nr 312, Datë 27.07.2018 Miratimi i projektit “Ndërtimi hidroenergjetik HEC Gurshpat 3” mbi përroin Gostimë, që derdhet në Shkumbin, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit		
--	--	--	--	--	--

			monument kulture ‘Ura e Gurit’ në fshatin Qukës, Bashkia Librazhd. • Punimet e HEC nuk kanë filluar. Punimet për monumentin ende nuk kanë filluar. Projekti nuk është realizuar ende. Objekti është rrënojë ka vetëm disa gjurmë të tij. 7. Vendimi Nr 314, Datë 27.07.2018 Miratimi i projektit “Ndërtimi i Hec Topcias” në lumin Shkumbin, Qarku Elbasan. - Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture “Këmbët e urës antike në Tropçias”, në fshatin Tropçias, Bashkia Elbasan. • Punimet e HEC nuk kanë filluar dhe mendohet të fillojnë rreth muajit shkurt 2025. Punimet për monumentin ende nuk kanë filluar. Projekti nuk është realizua rende. Objekti është rrënojë ka vetëm disa gjurmë të tij. 8. Vendimi Nr 322, Datë 27.07.2018 Miratimi i projektit “Ndërtimi i Hec Grabova 2”, në pellgun e përroit të Grabovës, me vendndodhje Bashkinë e Gramshit. - Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture “Ura Mesjetare e Gurrit në Grabovë të Sipërme”, Gramsh. • Punimet e HEC kanë filluar dhe janë në proces. Punimet për monumentin ende nuk kanë filluar. Projekti është hartuar nga IKTK dhe është miratuar nga KKR me vendimin nr. 237 datë 05.07.2019 dhe vendimin e KKTKM me vendimin nr. 238 datë 19.07.2024 9. Vendimi Nr 29, Datë 77.02.2019 Miratimi i projektit “Hidroenergjetik: “Hev Gurshpak” mbi përroin e Sulkuqit, degë e lumit Gostimë, që derdhet në lumin Shkumbin, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan. - Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture “Ura antike e Keçit, NJ.A Polis, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.		
--	--	--	--	--	--

				Punimet e HEC nuk kanë filluar. Punimet për monumentin ende nuk kanë filluar. Projekti nuk është realizuar ende. Objekti është rrënojë ka vetëm disa gjurmë të tij. 9. Vendimi Nr 225, Datë 14.06.2019 Miratimi i projektit “Ndërtimi i Hec Mario”, Bashkia Librazhd. – Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit munument kulture “Ura e Gurit”, në fshatin Qukës, Bashkia Prenjas. Punimet e HEC kanë filluar dhe janë në proces. Punimet për monumentin ende nuk kanë filluar. Projekti nuk është realizuar ende. Objekti është rrenojë ka vetëm disa gjurmë të tij. 10. Vendimi Nr 226, Datë 14.06.2019 Miratimi i projektit: “Ndërtimi i hidrocentralit Grabovë 2” mbi pellgun ujëmbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit Devoll, Qarku Elbasan. - Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit munument kulture “Ura Mesjetare e Gurit: në fshatin Grabovë e Sipërme, Bashkia Elbasan. Punimet e HEC kanë filluar dhe janë në proces. Punimet për monumentin ende nuk kanë filluar. Projekti është hartuar nga IKTK dhe është miratuar nga KKR me vendimin nr. 237 datë 05.07.2019 dhe vendimin e KKTKM me vendimin nr. 238 datë19.07.2024. 11. Për Vendimin Nr .176, datë 05/06/2017, Shoqëria private "Mati Hydropoëes" nuk ka kryer asnjë restaurim, por restaurimi është kryer nga vetë punëtorja e DRTK-Tiranë në vitin 2020. 12. Për Vendimin Nr.177, datë 05/06/2017, Shoqëria private "Mati Hydropoëes"	
--	--	--	--	--	--

				nuk ka kryer asnjë restaurim, por restaurimi është kryer nga vetë punëtorja e DRTK-Tiranë në vitin 2020. 13. Për Vendimin Nr.178, datë 05/06/2017, Shoqëria private "Mati Hydropoëes" nuk ka kryer asnjë restaurim, por restaurimi është kryer nga vetë punëtorja e DRTK-Tiranë në vitin 2020. 14. Për Vendimin Nr.300, datë 23/10/2017, Shoqëria private "Aris Albania" nuk ka kryer restaurim, por restaurimi është kryer nga vetë punëtorja e DRTK-Tiranë. 15. Vendimi nr. 317, datë 27.07.2018 '<i>Ndërtimi hidroenergjitik i Hidrocentralit Potam 1 dhe Potam 2, mbi lumin e Potamit, Bashkia Finiq</i>' Shoqeria nuk ka kontribuar, projekti i Urës së Leshnicës së Poshtme është miratuar me vendim të K.K.R-së nr. 334, datë 27.07.2018 dhe është rimiratuar me vendim të K.K.T.K.M-së nr. 214, datë 03.06.2022. Punimet e zbatimit për Hidrocentralet Potam 1 dhe Potam 2 ende nuk kanë filluar dhe nuk mund të marrim masa për sa kohë subjekti nuk ka filluar punimet. - Në lidhje me kërkesat e pikës 4 dhe 5 të parashtruara në kërkesë, sqarojmë se: Ne mbështetje të Ligjit nr. 27/2018 "<i>Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë</i>" dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij, nuk parashikohet kjo dispozit ligjore, por ne permbushje te qellimit teketij ligji qe eshte "... ruajtja, mbrojtja, vlerësimi dhe administrimi i trashëgimisë kulturore kombëtare, trashëgimisë kulturore muzeore, peizazhit, si kontribues në ruajtjen e kujtesës kombëtare, përfaqësimit material dhe të dukshëm të identitetit kombëtar,	
--	--	--	--	--	--

				<i>si shprehje e vlerave kulturore, si dhe nxitja e zhvillimit kulturor në vend, duke siguruar dhe parandalimin e trajtimit të paligjshëm të objekteve kulturore", si dhe bazuar në misionin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, duke ushtruar veprimtarinë e tij në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, me qëllim gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale, sa here që është parë e nevojshme, si edhe me dakortesinë në parim nga ana e subjekteve, është vlerësuar mundësia e arritjes së një marreveshjeje me këto subjekte që gjatë periudhës së zbatimit të projekteve të kësaj natyre të kontribuojnë edhe në mirëmbajtjen/restaurimin e objekteve që kanë statusin pasuri kulturore dhe ndodhen përreth territorit që ata do të zbatohen projektin e tyre.</i>		
6	29.10.2024	1. A është ky vendim në përputhje të plotë me ligjin aktual për trashëgiminë kulturore, i cili ndalon që projektet kërkimore arkeologjike të kryhen nga privatët? 2. Pse është marrë vendimi për të përjashtuar Institutin e Arkeologjisë nga gërmimet dhe kërkimet në zonat e mbrojtura arkeologjike dhe monumentet e shpallura? Cilat janë arsyet ligjore dhe shkencore për këtë vendim? 3. Arkeologët ankohen se ka mungesë koordinimi ndër-institucional për projektet arkeologjike në Durrës? A ka në plan	05.11.2024	Në përgjigje të kërkesës së Z. _____ “Kërkesë për koment”, në lidhje me konceptin e gërmimeve arkeologjike për zonën e Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin dhe Banjave Romake, përcjellë për kompetencë pranë IKTK me emailin e datës 29.10.2024, sqarojmë si vijon: Së pari saktësojmë se vendimi i Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM), për miratimin e konceptit të gërmimeve për zonën e Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin dhe Banjave Romake, nuk është vendimi nr. 435 datë 25.07.2023, por Vendim nr. 436 datë 25.07.2023.	E plotë	Jo

		Ministria të krijojë një mekanizëm të përhershëm për bashkëpunim më të mirë me IA dhe Akademinë e Shkencave? 4. Pse është vendosur që gërmimet të kryhen nga subjekte private, dhe si garantohen standardet shkencore e arkeologjike në këtë rast? 5. Çfarë mekanizmash ka Ministria për të monitoruar cilësinë dhe ndikimin e projekteve të zhvilluara nga subjekte private në zonat e mbrojtura arkeologjike?	Së dyti, sqarojmë se KKTKM është organ kolegjal vendimarrës dhe IKTK nuk ka kompetence ligjore për të interpretuar vendimet e marra prej tij. Vendimi nr. 436 datë 25.07.2023 i KKTKM për konceptin e gërmimeve arkeologjike për zonën e Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin dhe Banjave Romake në qytetin e Durrësit është marrë në kuadër të projektit “Hartimi i Planeve të Konservimit dhe Gërmimeve arkeologjike të Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin dhe Banjave Romake, dhe të Shtigjeve Urbane në zonat arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit”, me zhvillues Ministrinë e Kulturës (aktualisht Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit). Sa i përket bazës ligjore të vendimit të sipërcituar, si në çdo rast tjetër, vendimmarrja e KKTKM bazohet në dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr.27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, si dhe aktet nënligjore në fuqi. Konkretisht, për hulumtimet arkeologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë ligji nr.27/2018, neni 134 pika 6 e tij përcakton se: <i>“....Hulumtimet arkeologjike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë ekskluzivitet i institucioneve të specializuara të trashëgimisë kulturore ose subjekteve të licencuara sipas këtij ligji, në përputhje me rregullat që hartohen nga institucionet e specializuara shtetërore. Procedura për hulumtimet arkeologjike rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe propozim të IKTK-së....”</i>. Përfaqësues të Institutit të Arkeologjisë, kanë qenë pjesë përbërëse e ekipeve të hartimit të termave të referencës për projektin e sipërcituar, si dhe anëtarë të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale(KKTKM), gjatë shqyrtimit dhe miratimit të konceptit të gërmimit arkeologjik për zonën e Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin dhe Banjave Romake. Në lidhje me aktivitetin kërkimor – shkencor të Institutit të Arkeologjisë në hapësirat e Amfiteatrit të Durrësit dhe Forumit Romak, Ju bëjmë me dije se projektet vijnë normalisht punën në këto zona dhe në asnjë rast nuk janë përjashtuar nga aktiviteti në këtë zonë. Gjatë këtij viti në zonën e Amfiteatrit të Durrësit dhe Forumit Romak janë	
--	--	--	--	--

				zhvilluar dy projekte të Institutit të Arkeologjisë, të cilat janë miratuar nga KKTKM, përkatësisht projektet: “Kërkime në Forumin Rrethor të Durrësit” (Vendim nr. 280 datë datë 26.7.2024 i KKTKM); “Durrësi Mesjetar – Amfitatri 2024”, (vendimi 323, date 23.08.2024) Në lidhje me mekanizmin e kontrollit dhe mbikëqyrjes së projekteve arkeologjik të cilat kryhen nga institucione të specializuara, ose subjekte të licencuara në fushën e arkeologjisë, sqarojmë se ato janë përcaktuar në ligjin nr.27/2018, ku në çdo rast janë Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore. Bashkëlidhur gjeni vendimet e KKTKM për projektet e Institutit të Arkeologjisë të miratuara për vitin 2024 për zonën e Amfiteatrit dhe Forumit Romak.		
7	25.11.2024	Dokumentacioni për Qendrën Historike dhe Arkeologjike të qytetit të Elbasanit.: 1. Harta e monumenteve të kultures 2. Pasaporta monumenti	03.12.2024	Bashkëlidhur gjeni informacionin qeIKTK disponon ne lidhje me hartat per pasurite kulturore te qytetit te Elbasanit, ndersa ne lidhje me piken 2 te kerkeses, lutemi drejtohuni tek Instituti Kombetar i Regjistrimit te Trashegimise Kulturore, ne adresen info@ikrtk.gov.al.	E plotë	Jo
8	22.11.2024	Kërkesë për Informacion në lidhje me procesin e gërmim shpëtimit në Parqet Arkeologjike të Shqipërisë.	03.12.2024	Në përgjigje të kërkesës Suaj, përcjellë në adresën elektronike zyrtare të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), më datë 22.11.2024, nga ku kërkohet informacion për gërmimet arkeologjike të realizuara nga IKTK në 10 vitet e fundit në parqet arkeologjike, Ju bëjmë me dije se: Bazuar në Ligjin Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Neni 29, pika 3 përcakton se: <i>3. IKTK-ja ushtron veprimtarinë në fushën e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike, si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë.</i> Në përmbushje të detyrave funksionale të IKTK-së, bazuar në Rregulloren e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të IKTK-së, Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik (IKTK) ka	E plotë	Jo

			kryer bashkëpunime me Parqet arkeologjike dhe Drejtoritë Rajonale të Kulturës për realizimin e gërmimeve arkeologjike të shpëtimit, të cilat do të listohen më poshtë. Vendim Nr. 360, datë 26.11.2014 i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (sot Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, KKTKM); Gërmimi arkeologjik i shpëtimit për evidentimin e murit dhe dokumentimit të tij, pranë godinës së Bashkisë Lezhë, sheshi “Gjergj Kastrioti”, realizuar nga DRRK Shkodër (sot DRTK Shkodër) dhe Agjencia e Shërbimit Arkeologjik (sot Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik pranë IKTK-së), në kuadër të projektit: “<i>Rehabilitimi i Qendrës Historike të qytetit të Lezhës</i>”. Vendim Nr.22, datë 11.03.2015 i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (sot Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, KKTKM); Gërmimi i varreve të hapura në mënyrë klandestine në Orikum, realizuar nga ASHA dhe DRKK Vlorë. Vendim Nr. 118, datë 18.11.2015 i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (sot Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, KKTKM); Dokumentimi i varreve të hapura nga gërmimet klandestine në zonën e quajtur Sadovinë, Nekropoli i qytetit antik të Orikumit-Vlorë, faza 1, 2 dhe 3, realizuar nga ASHA dhe DRKK Vlorë. Vendim Nr. 227, datë 17.10.2018 i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (sot Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, KKTKM); Gërmim arkeologjik i shpëtimit dhe dokumentimit të varrit në kuadër të gërmimeve të paautorizuara në Parkun arkeologjik të Amantias, realizuar nga DRKK Vlorë, ASHA dhe Instituti i Arkeologjisë. Vendim Nr. 57, datë 19.02.2020 i Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale		
--	--	--	---	--	--

				(KKTKM); Gërmim arkeologjik i shpëtimit dhe dokumentimit të varrit antik nr. 16, në nekropolin verilindor të Parkut arkeologjik Amantia, realizuar nga DRTK Vlorë dhe DSHA. 6. Vendim Nr. 381, datë 06. 11. 2020 i Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM). Miratimi i relacionit mbi verifikimin në terren për varrin antik të zbuluar nga persona të pa autorizuar pranë kullës me hark në Parkun Arkeologjik të Amantias, realizuar nga DSHA dhe DRTK Vlorë. Sa më sipër, Ju informojmë se rezultatet e gërmimeve arkeologjike janë të botuara në revistat shkencore të fushës së arkeologjisë dhe trashëgimisë kulturore në vendin tonë (Revista Iliria, Candavia, Academia.edu, Raportet vjetore të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik).		
--	--	--	--	---	--	--